

Aktiviteti 11.2

Studimi i përcjellshmërisë me anë të filmit termokolor

Aftësitë

- A03.1** Të tregohet se dini të përdorni teknikat, aparatet dhe materialet në mënyrë të sigurt (përfshirë këtu ndjekjen e një radhe instruksionesh aty ku duhet).
- A03.2** Të planifikoni eksperimente e hulumtime.
- A03.3** Të bëni dhe regjistroni vëzhgime, matje dhe vlerësime.
- A03.4** Të interpretoni dhe vlerësoni vëzhgime, eksperimente dhe të dhëna.

Do të studioni përcjellshmërinë termike me ndihmën e filmit termokolor.

Masa sigurie

Kujdes kur kapni enën me ujë të nxehtë. Ena mjafton të mbushet përgjysmë dhe temperatura e saj duhet të jetë më e ulët se 50°C.

Çfarë do të bëni

Filmi termokolor ndryshon ngjyrë kur nxehet, ndaj mund ta përdorni për të parë se ku është përcjellë nxehtësia. Ja disa prova që mund të bëni:

- 1** Prekni me majat e gishtave një fletë filmi termokolor. Hiqini gishtat. Çfarë shihni?
- 2** Vendoseni fletën brenda një libri. Mbi libër vendosni një enë me ujë të nxehtë. Pas një minute vrojtoni fletën dhe shpjegoni atë që shihni.
- 3** Me anë të fletës së filmit termokolor hulumtoni përcjellshmërinë e nxehtësisë përmes qelqit, plastikës dhe një flete alumini.